VENDIM
Nr.193, datë 25.3.2005

PËR KRITERET E PRANIMIT TË NËNOFICERËVE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 34 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtetasi shqiptar, për t'u pranuar nënoficer aktiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, përveç kushteve të përcaktuara në ligjin nr.9171, datë 22.1.2004 "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", duhet të plotësojë, detyrimisht, edhe këto kritere:

a) Të ketë kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, për meshkujt, ose të ketë kryer programin e stërvitjes bazë, në qendrën stërvitore Bunavi dhe stërvitjen individuale në shkollën e trupës, për femrat;

b) Të përmbushë format e testimit shëndetësor, fizik dhe intelektual, të miratuara nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

c) Të ketë përfunduar detyrimisht Akademinë e Nënoficerëve "Lodewijk W.J.K.Tomson", Tiranë ose një akademi ushtarake jashtë vendit, të njësuar me të.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano